

Projekti “Siguri energjetike nëpërmjet zbutjes së varfërisë energjetike”

Projekti “Siguri energjetike nëpërmjet zbutjes së varfërisë energjetike” është një projekt 7 mujor me kohezgjatje prill – nëntor 2023, me vlerë 7798 euro i financuar nga projekti SMART Balkans -Shoqëria Civile për Vlera të Përbashkëta në Ballkanin Perëndimor, numri i referencës së thirrjes: SB ALB LI 01/22.

Projekti “Siguri energjetike nëpërmjet zbutjes së varfërisë energjetike”, **zbatohet nga shoqata “Për Mirëqënie Sociale dhe Mjedisore” Berat** dhe mbështetet vullnetarisht nga Qendra Mjedisore për Zhvillim, Edukim dhe Rrjetëzim (EDEN) Tirane, Agjencia e Demokracisë Lokale (LDA) Vlorë, Qendra e Informacionit Aarhus Shkoder (AIC) dhe Klubi Ekologjik Elbasan (KEE).

Shoqata “Për Mirëqënie Sociale dhe Mjedisore” Berat ka konceptuar një veprim që synon të kontribuojë në forcimin e rolit, përfshirjes dhe influencës së shoqërisë civile në mobilizimin e aktorëve lokalë dhe rajonalë për rritjen e influencës qytetare dhe sjelljen e ndryshimit pozitiv në dobi të menaxhimit proaktiv dhe aktiv të varfërisë energjetike në vend.

Ndërhyrja do të rrisë kapacitetin advokues, rolin dhe ndikimin e shoqërisë civile për një qasje proaktive dhe përfshirje të aktorëve lokalë të interesit në politikat dhe praktikat që trajtojnë problemet e varfërisë energjetike në nivel vendor, me fokus Bashkinë e Beratit dhe përfshirje të grupeve të interesit nga Bashkitë, Tiranë, Shkodër, Vlorë, Elbasan.

Projekti “Siguri energjetike nëpërmjet zbutjes së varfërisë energjetike” do të arrijë qëllimin e tij nëpërmjet rritjes së ndërgjegjësimit, njohurive të përmirësuara dhe zhvillimit të kapaciteteve të aktorëve të interesit në territorin e synuar në lidhje me politikat dhe praktikat që trajtojnë problemet e varfërisë energjetike në nivel vendor, duke u mbështetur në praktikën Evropiane.

Ai do të kontribuojë në krijimin e një rrjeti aktiv të aktorëve të interesit në territorin e synuar për të garantuar përfshirje dhe rritje të influencës qytetare në proceset e menaxhimit proaktiv dhe aktiv të varfërisë energjetike. Aktorët lokalë të interesit të rrjetëzuar, do të nxiten dhe orientohen të ndërmarrin nisma advokuese për parandalimin dhe zbutjen e problematikave të varfërisë energjetike në nivel vendor.

Për më shumë informacion, ju lutem kontaktoni me e-mail: mireqeniesociale@gmail.com ose me tel: 0684094694